REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

# Urdhër Nr. 794, datë 28.12.2012 i Ministrit të METE “Mbi hartimin e Planit Kombëtar Sektorial për projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)”

## NE KUADËR TË

# PLANIT KOMBËTAR SEKTORIAL PËR GAZSJELLËSIN TRANS ADRIATIK

## Shtojca 1

**Tirane, Shkurt, 2013**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZËVENDËSKRYEMINISTRI
MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001 Faqja web: http://www.mete.gov.al

100 Vjet Pavarësi

# URDHËR

**Nr. _____, Datë. ____._____.2012**

**PËR**

**HARTIMIN E PLANIT KOMBËTAR SEKTORIAL PËR PROJEKTIN E GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP)**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës; të pikave 1 dhe 5 të nenit 33, të pikave 2 dhe 3 të nenit 34, nenit 36, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 "Për Planifikimin e Territorit", i ndryshuar; si dhe të neneve 4, 5 dhe 6 të VKM nr 481, datë 22.06.2011, "Për miratimin e rregullores uniforme të instrumenteve të planifikimit",

**URDHËROJ:**

1.- Fillimin e hartimit të Planit Kombëtar Sektorial për Projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP).

2.- Miratimin e Planit të Veprimit për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial për projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), sipas dokumentit bashkëngjitur këtij Urdhri.

3.- Grupi i ekspertëve të METE të angazhuar pranë Grupit Ndërinstitucional të Punës të ngritur me Urdhrin nr. 45, datë 09.04.2012, të Kryeministrit, "Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për negocimin me përfaqësuesit e kompanisë "TAP AG" për përgatitjen e licencës së koncesionit për projektin e gazsjellësit TAP", i ndryshuar, të konsultojë dhe do të mbikëqyrë hartimin e Planit Kombëtar Sektorial, bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga ana e kompanisë Trans Adriatic Pipeline AG.

4.- Grupi i ekspertëve të METE të bashkëpunojë dhe të këshillohet me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), gjatë procesit të hartimit të Planit Kombëtar Sektorial për projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP).

5.- Grupi i ekspertëve të METE gjatë procesit të hartimit të Planit Kombëtar Sektorial për projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP) të bashkëpunojë me strukturat përkatëse të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (MPPT), Ministrisë së

Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU), Ministrisë së Financave (MF), Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MTKRS), Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK), si dhe të Këshillave të Qarqeve Korçë, Berat dhe Fier.

5.- Ky Urdhër të botohet në faqen zyrtare të METE në internet, si dhe t'i bëhet i njohur kompanisë TAP AG dhe AKPT

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**EDMOND HAXHINASTO**

## Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP)
## Plani i veprimit për hartimin e Planit Sektorial Kombëtar për Gazsjellësin Trans Adriatik

| ID | | Emërtimi i Procesit | Koha (në ditë) | Fillimi | Fundi | Institucioni |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | **Projekt Plani Kombëtar Sektorial për Projektin TAP** | **180 d** | **9/20/12** | **5/29/13** | |
| 2 | | **Nisma per fillimin e hartimit te Planit Kombetar Sektorial per Projektin TAP** | **100 d** | **9/20/12** | **2/6/13** | **METE** |
| 3 | | Botimi i Planit të Veprimit dhe i Propozimit të TAP në regjistrin e planifikimit të territorit të METE-s dhe dërgimi i propozimit tek ministritë e linjës per marrjen e mendimit te tyre per fillimin e hartimit Planit Kombëtar Sektorial për Projektin TAP | 40 d | 9/20/12 | 11/14/12 | METE |
| 4 | | Marrja e mendimit te ministrive te linjes mbi fillimin e hartimit te PKS per projektin TAP dhe planin e veprimit | 25 d | 11/15/12 | 12/19/12 | METE |
| 5 | | Përgatitja dhe miratimi i projekt urdhrit të Ministrit për miratimin (i) e fillimit të hartimit te Planit Kombëtar Sektorial për Projektin TAP; (ii) miratimin e planit të veprimit | 5 d | 12/20/12 | 12/26/12 | METE |
| 6 | | METE harton Planin Kombëtar Sektorial për Projektin TAP; Vleresimi Strategjik Mjedisor eshte pjese e tij | 30 d | 12/27/12 | 2/6/13 | METE |
| 7 | | **METE fillon konsultimin dhe bashkerendimin e Planit Kombëtar Sektorial për Projektin TAP** | **60 d** | **2/7/13** | **5/1/13** | **METE** |
| 8 | | Botimi i Planit Kombëtar Sektorial për Projektin TAP në regjistrin e METE-s dhe, ose METE ia dërgon Planin kombëtar Sektorial për Projektin TAP ministrive të linjës dhe qarqeve; VSM dergohet tek MMPAU; Njoftimi i dates se seances degjimore | 30 d | 2/7/13 | 3/20/13 | METE |
| 9 | | Konsultimi me Ministrite e linjes dhe qarqet Korçë, Fier dhe Berat | 30 d | 2/7/13 | 3/20/13 | METE |
| 10 | | Reflektimi i te gjitha komenteve te institucioneve bazuar ne procesin e konsultimit dhe bashkerendimit | 7 d | 3/21/13 | 3/29/13 | METE |
| 11 | | Zhvillimi i seances degjimore per Projektin e Planit Sektorial Kombetar per Projektin TAP | 1 d | 4/1/13 | 4/1/13 | METE |
| 12 | | Reflektimi i te gjitha komenteve sipas procesit te kosultimit dhe bashkerendimit dhe seances degjimore ne dokumentin bashkelidhur Planit Kombetar Sektorial per Projektin TAP | 5 d | 4/2/13 | 4/8/13 | METE |
| 13 | | METE dërgon komente në lidhje me procesin e Vleresimit Strategjik Mjedisor (VSM) për MMPAU | 2 d | 4/9/13 | 4/10/13 | METE |
| 14 | | Leshimi i Deklarates Mjedisore | 3 d | 4/11/13 | 4/15/13 | MMPAU |
| 15 | | Dërgimi i Projekt Planit Kombetar Sektorial per Projektin TAP ne AKPT | 3 d | 4/16/13 | 4/18/13 | METE |
| 16 | | **AKPT-ja rishikon përputhshmërinë e instrumentit planifikues me instrumentet ekzistuese të planifikimit** | **9 d** | **4/19/13** | **5/1/13** | **AKPT** |
| 17 | | AKPT-ja rishikon përputhshmërinë e instrumentit planifikues me instrumentet ekzistuese planifikuese | 8 d | 4/19/13 | 4/30/13 | AKPT |
| 18 | | AKPT-ja ia dërgon Planin Kombëtar Sektorial për Projektin TAP, KKT-së për miratim | 1 d | 5/1/13 | 5/1/13 | AKPT |
| 19 | | **Miratimi nga KKT i Planit Kombetar Sektorial per Projektin TAP** | **20 d** | **5/2/13** | **5/29/13** | |
| 20 | | Miratimi I KKT-së për Planin Kombëtar Sektorial për projektin TAP | 15 d | 5/2/13 | 5/22/13 | KKT |
| 21 | | AKPT-ja boton vendimin e KKT-së për Planin Kombëtar Sektorial për projektin TAP në regjistrin e planifikimit të territorit brenda 15 ditësh nga dita e miratimit | 5 d | 5/23/13 | 5/29/13 | AKPT |

